# PRAKTIKA TË MIRA NË BASHKITË E QARKUT ELBASAN

Projekti: Qytetarë aktivë për monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike vendore nëpërmjet "Teknikave të Vëzhguesve të Trajnuar"



U R I

Klubi Ekologjik, Elbasan KEE
Ecological Club,Elbasan ECE

Teknikat e Vëzhguesve të Trajnuar

Financuar nga LevizAlbania

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është përgatitur nga **Instituti i Kërkimeve Urbane**, në konsultim të ngushtë me organizatën partnere **Klubi Ekologjik Elbasan** në kuadër të projektit Qytetarë aktiv për monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike vendore nëpërmjet 'Teknikave të Vëzhguesve të Trajnuar' i zhvilluar me mbështetjen financiare të **Lëviz Albania**, një projekt i **Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe bashkëpunim SDC**.

Përmbajtja e këtij raporti paraprak është përgjegjësi vetëm e partneritetit ndërmjet Institutit të Kërkimeve Urbane dhe Klubit Ekologjik Elbasan, mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me mendimet e donatorit.

Financuar nga LevizAlbania

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

# PËRMBAJTJA


6 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
6 ÇFARË ËSHTË TEKNIKA E VËZHGUESVE TË TRAJNUAR?
7 METODOLOGJIA
8 PËRZGJEDHJA E VËZHGUESVE
8 BASHKËPUNIMI ME BASHKITË DHE KËSHILLAT BASHKIAK

## BASHKIA CERRIK

Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake..... 36
Parqet dhe lulishtet..... 37
Shkollat..... 44
Prania e rampave..... 45
Ngrohja..... 45

## BASHKIA GRAMSH

Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake..... 11
Parqet dhe lulishtet..... 15
Shkollat..... 20
Prania e rampave..... 21
Ngrohja..... 21

## BASHKIA PEQIN

Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake..... 48
Parqet dhe lulishtet..... 51
Shkollat..... 55
Prania e rampave..... 56
Ngrohja..... 56

## BASHKIA BELSH

Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake..... 24
Parqet dhe lulishtet..... 27
Shkollat..... 32
Prania e rampave..... 33
Ngrohja..... 33

## BASHKIA ELBASAN

Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake..... 60
Parqet dhe lulishtet..... 63
Shkollat..... 68
Prania e rampave..... 69
Ngrohja..... 69

## LISTA E AKRONIMEVE

| | |
|---|---|
| KEE | Klubi Ekologjik Elbasan |
| PAK | Persona me Aftësi të Kufizuar |
| URI | Instituti i Kërkimeve Urbane |
| QSHA | Qendra e Shërbimeve Arsimore |

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti "Qytetarë aktive për monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike vendore nëpërmjet "Teknikave të Vëzhguesve të Trajnuar" prezanton Teknikën e Vëzhguesve të Trajnuar (TVT), me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të administratës vendore për të monitoruar e vlerësuar ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet bashkëpunimit me vetë qytetarët që i përfitojnë ato.

Zbatimi i Teknikës së Vëzhguesve të Trajnuar ndihmon në sigurimin e një mjedisi më të pastër dhe rekreativ në zonat urbane. Teknika e Vëzhguesve të Trajnuar u zbatua gjatë periudhës janar – dhjetor 2021 në Qarkun e Elbasanit, në bashkitë Elbasan, Gramsh, Peqin, Cërrik, Belsh. Qytetarë të këtyre bashkive u trajnuan, dhe më pas, të ndarë në grupe, vlerësuan cilësinë e ofrimit të tre shërbimeve publike vendore të përzgjedhura:

• Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake;

• Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike - infrastuktura Persona me Aftësi të Kufizuara (PAK) do të jetë pjesë e vlerësimit;

• Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor para universitar - infrastuktura PAK do të jetë pjesë e vlerësimit.

Në bashkitë Elbasan, Gramsh, Peqin, Cërrik, Belsh u zhvilluan dëgjesa publike me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse për shërbimet publike pranë bashkive, përfaqësues të këshillave bashkiake, si dhe qytetarë, me qëllim prezantimin e metodologjisë, vëzhguesve dhe të rezultateve të projektit.

Gjatë vëzhgimit dhe vlerësimit të komponentëve të shërbimit – Parqe, lulishte dhe hapësira të gjelbra publike dhe shërbimit – Ndërtimi, rehabilitim dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit para universitar në fokus do të jenë personat me aftësi të kufizuar (PAK) dhe mundësitë që ju ofrohen atyre në lidhje me këto dy shërbime.

## ÇFARË ËSHTË TEKNIKA E VËZHGUESVE TË TRAJNUAR?

Teknikat e Vëzhguesve të Trajnuar përdoret për të matur cilësinë e ofrimit të shërbimeve nëpërmjet shqisës së të parit. Individë të trajnuar të cilët mund të punojnë në grup ose individualisht vlerësojnë ofrimin e një shërbimi nëpërmjet një shkalle matëse të paracaktuar. Kjo është një procedurë e saktë vlerësimi e cila ndihmon në rritjen e bashkëpunimit midis njësive të qeverisjes vendore dhe qytetarëve. Nëse këto vlerësime kryhen me të njëjtën teknikë ato mund të përdoren për të krahasuar ofrimin e shërbimit në vazhdimësi. Nga ana tjetër përfshirja e qytetarëve në aplikimin e kësaj teknike i ndihmojnë ata të advokojnë për ofrimin e Shërbimeve Publike me një standard më të lartë nga ana e bashkisë.

Teknikat e Vëzhguesve të Trajnuar mund të përdoret për vlerësimin e disa

shërbimeve si psh:
- cilësia e rrugëve dhe trotuareve;
- cilësia e banesave sociale;
- cilësia e godinave të shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave shëndetësore;
- mirëmbajtja e parqeve publike;
- pastrimi dhe largimi i mbetjeve

Disa avantazhe të përdorimit të kësaj teknike:
- kosto e ulët në aplikim;
- e lehtë për t'u kuptuar;
- praktike në përdorim;
- shumë përfshirëse.

## METODOLOGJIA

Teknika e Vëzhguesve të Trajnuar po zbatohet në 7 bashkitë e qarkut Elbasan. Në secilën bashki janë trajnuar persona për aplikimin e Teknikës së Vëzhguesve të Trajnuar në terren. Qytetarët më pas të ndarë në grupe kanë vijuar punën në terren për të monitoruar ofrimin e 3 shërbimeve publike vendore.

Shkalla matëse për vlerësimin e komponentëve të këtyre shërbimeve është si më poshtë:
1. Shumë, mirë;
2. Mirë;
3. Keq;
4. Shumë keq.

Shërbimet publike vendore të përzgjedhura  për tu vëzhguar janë:

1. Shërbimi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, për të cilin u vëzhguan komponentët e mëposhtëm:
- Mbetjet voluminoze përreth kontejnerëve (kuti kartoni, inerte, pajisje elektro-shtëpiake);
- Pastërtia e mjedisit përreth kontejnerëve;
- Shkalla e mbushjes së kontejnerëve;
- Gjendja fizike e kontejnerëve;
- Vendqëndrimi i kontejnerëve

2. Mirëmbajtja e parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike, për të cilin u vëzhguan komponentët e mëposhtëm:
Infrastuktura PAK do të jetë pjesë e vlerësimit
- Pemët dhe shkurret;
- Bari;
- Zona e lojërave;
- Lojëra për personat me aftësi të kufizuar
- Pastërtia;
- Objekte sanitare në park.

3. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor para universitar, për të cilën u vëzhguan komponentët e mëposhtëm:
Infrastuktura PAK do të jetë pjesë e vlerësimit
- Tualeti, higjiena;
- Tualeti, infrastruktura;
- Dritaret;
- Prania e rampave për PAK;
- Sistemi i ngrohjes.
Modalitetet e përdourura nga vëzhguesit e trajnuar për dokumentimin e vëzhgimeve:
- Fotografimi;
- Formularët e vlerësimit.
Vëzhguesit e secilës bashki kryen gjithsej dy vëzhgime për tre shërbimet në intervale të rregullta kohore gjatë muajit prill dhe maj. Në përfundim të

tyre, ekspertët përpunuan të dhënat në programit Excel të Microsoft Office, duke përftuar rezultatet e agreguaraa dhe të mësatarizuara për secilin shërbim, si dhe i paraqitën ato në formë grafike.

## PËRZGJEDHJA E VËZHGUESVE

Vëzhgues të kualifikuar janë grupe qytetarësh vullnetarë të profesioneve të ndryshme, jo të punësuar nga bashkia, por që bashkëpunojnë me stafin e bashkisë, të cilët trajnohen më parë për të përdorur të njëjtën metodë vlerësimi në terren.

Në këtë projekt është dakordësuar që do të trajnohen 12 persona për secilën bashki, të cilët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- jo më pak 30% e qytetarëve të jenë femra;
- të kenë përfunduar apo të jenë në vazhdim të shkollës së mesme;
- të jenë banorë të bashkisë ku do të zbatohet projekti;
- të kenë një aparat celular me të cilin do të kryej fotografi në terren;
- të jenë përdorues te programeve Word, Excel.

## BASHKËPUNIMI ME BASHKITË DHE KËSHILLAT BASHKIAK

Bashkëpunimi i organizatave me bashkitë filloi që në fazën e trajnimit të vëzhguesve, ku administrata publike u njoh me metodologjinë e teknikës dhe me qytetarët t ë cilët do të zbatonin atë në tërritorin e bashkisë, me qëllimin për të ngritur një marredhënie besimi dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve.

Zyrtarët e bashkive përshëndetën përfshirjen e qytetarëve në këtë projekt për monitorimin dhe vlerësimin e ofrimit të shërbimeve publike; anëtarët e këshillave bashkiak u shprehën të hapur për të pritur rezultatet dhe rekomandimet e projektit për t'i paraqitur në mbledhjen e ardhshme të këshillit bashkiak. Në bashkitë e Qarkut Elbasan, rezultatet e përftuara nga zbatimi i teknikës u përkthyen në format e kërkesave buxhetore dhe iu paraqitën zyrtarëve të bashkisë, si dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë në dëgjesat publike të zhvilluara për këtë qëllim.

# REZULTATET E PROJEKTIT


# BASHKIA GRAMSH

Bashkia e Gramshit ndodhet në pjesën qëndrore dhe jugore të Shqipërisë, nga Qafa e Shënkollit, Lleshan në veri deri në Siman në jug dhe nga Saraseli në perëndim deri në malin e Valamarës, Lenie në lindje. Bashkia e Gramshit bën pjesë në Qarkun e Elbasanit. Bashkia Gramsh ka në përbërje të saj 10 njësi administrative: Gramsh – qendra e Bashkisë, Pishaj, Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult, Tunjë, me një popullësi gjithsej prej 24,231 banorësh, sipas INSTAT, Census 2011.

Bashkia e Gramshit ka një reliev kodrinor-malor, me një mesatare prej 804 m mbi nivelin e detit, me lartësi minimale 119 m mbi nivelin e detit dhe maksimale 2373 m. Bashkia e Gramshit ka një reliev kryesisht të thyer, i cili vjen duke u ngritur nga perëndimi në drejtim të lindjes. Lumi i Devollit është një urë ndarëse midis relievit më të ulët në perëndim dhe relievit më malor në lindje. Bashkia e Gramshit futet në zonën klimatike mesdhetare kodrinore nënzona jugperëndimore që shtrihet deri në 800 -1000 m mbi nivelin e detit dhe në zonën klimatike mesdhetare malore nënzona juglindore pjesa e sipërme e relievit deri në lartësinë 2373 m. Temperatura mesatare e ajrit është 12.3 °C-15.1 °C për zonat e ulëta dhe 9.5 °C-10.9 °C për zonën malore.




# PËRMBLEDHJE E GJETJEVE NGA VËZHGIMI I KRYER NË TERREN NË BASHKINË GRAMSH




## SHËRBIMI I MBLEDHJES, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE

Vëzhguesit e trajnuar kanë monitoruar komponentët e përcaktuar të shërbimit të mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake me një frekuencë një herë në javë, për dy javë, në 10 pika grumbullimi dhe 21 kontejnerë. Në vijim paraqiten grafikisht rezultatet e mesatarizuara të vëzhgimeve për këtë shërbim.





**Mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq










**Vendqëndrimi i kontejnerëve**

- Mirë
- Keq








**Pastërtia rreth kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq




**Shkalla e mbushjes së kontejnerit**

- Mirë
- Keq




**Gjendja fizike e kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Shumë keq






## Gjetje

- Në nivel të përgjithshëm komponentët si mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerit, pastërtia rreth kontejnerëve, shkalla e mbushjes dhe gjendja fizike e kontejnerëve janë vlerësuar me mirë dhe shumë mirë.


- Sipas vlerësimit të vëzhguesve, komponenti vendqëndrimi i kontejnerëve është vlerësuar me keq. Në këtë rast duhet të kryhen ndërhyrje për të ndërtuar 8 platforma për vendqëndrimet e kontejnerëve, në mënyrë të tillë, që kontejnerët të kenë vendin e tyre e mos kthehen në burim incidenti apo të lëvizen nga pozicioni qe ka vendosur bashkia.

- Vëzhguesit kanë vlerësuar gjendjen fizike të 21 kontejnerëve. Pjesa më e madhe e kontejnerëve lidhur me komponentin gjendja fizike janë vlerësuar me shumë mirë. Sipas vlerësimit të vëzhguesve nevojitet blerja e 1 kapaku dhe 2 rrotave për një kontejner, i cili është vlerësuar me keq.

# PARQET DHE LULISHTET





Vëzhguesit e trajnuar kanë monitoruar komponentët e përcaktuar të shërbimit të mirëmbajtjes së parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike me një frekuencë njëhere në javë, për dy javë, në tre lulishtet e njohura nga banorët si: lulishtja tek shatërvani poshtë; lulishtja te shatërvani lart dhe zona Sporti 2. Në vijim paraqiten grafikisht rezultatet e mesatarizuara të vëzhgimeve për këtë shërbim.





**Mirëmbajtja e pemëve, shkurreve**

Shumë mirë




**Mirëmbajtja e barit**

Shumë mirë
Mirë
Keq





**Zona e lojërave**

Keq
Shumë keq









**Zona e lojërave dhe aksesi për PAK**

Po, ka
Jo, nuk ka









**Pastërtia e parqeve**

Shumë mirë
Keq











**Rrugët e kalimit në parqe**

Shumë mirë









**Mirëmbajtja e stolave**

Shumë mirë
Mirë
Keq
Shumë keq








## GJETJE

- Si shqetësim i parë nga vëzhguesit vërehet nevoja për të mirëmbajtur më tepër barin/tapetin e gjelbër, i cili shpesh mungon në sipërfaqen e tokës.

- Vëzhguesit kanë vlerësuar nevojën për investime për zëvendësimin e lojërave të dëmtuara, riparimin dhe blerjen e lojërave te reja, të cilat janë gjithashtu një nevojë e kësaj bashkie, në veçanti, për 3 lulishtet e njohura nga komuniteti, të cilat janë Lulishtja tek Shatërvani poshtë; Lulishtja tek shatërvani lart, dhe Sporti 2. Riparimi ose zëvëndësimi i lojërave është i nevojshëm sepse këto lojëra mund të bëhen të rrezikshme për fëmijët.

- Në këtë bashki mungojnë hapësirat e dedikuara për personat me aftësi të kufizuar. Për këtë arsyje është e nevojshme të merren masa si p.sh, vendosja e lojërave të përshtatshme për të siguruar aksesin e tyre në zonat e monitoruara. Në këtë rast vendosja e lojërave është e rëndësishme, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuar të kenë mundësi të argëtohen dhe të ndihen të barabartë më fëmijët e tjerë.

- Vëzhguesit kanë vlerësuar të nevojshëm blerjen e 2 stolave të rinj në lulishtet e njohura nga komuniteti “Shatërvani poshtë” dhe “Sporti 2” dhe riparimi i 3 të tjerëve, të cilët kanë nevojë për lyerje apo për vendosjen e 1-2 derrasave në lulishten “Shatërvani poshtë”.


- Rikonstruksioni i plotë i objektit sanitar të gjendur tek lulishtja “Shatërvani poshtë”, i cili nga monitorimi është vlerësuar plotësisht jofunksional për banorët e komunitetit.


# SHKOLLAT

Për qëllimin e këtij projekti është vlerësuar shkolla e mesme 'Shefqet Guzi' në qytetin e Gramshit, e cila ndodhet në lagjen "Sporti".


Shkolla e mesme e përgjithshme "Shefqet Guzi" ka dhe numrin më të madh të nxënësve të arsimit të mesëm në këtë bashki.

**Gjendja e tualetit**




**Mirëmbajtja e higjienës**








## PRANIA E RAMPAVE

Në gjimnazin 'Shefqet Guzi' nuk janë të pranishme rampat për personat me vështirësi në lëvizje si në pjesën e jashtme të saj, ashtu edhe në atë të brendshme. Për këtë arsye sugjerojmë ndërtimin e një rampe minimalisht në hyrjen e shkollës pasi ka një kosto të ulët e më pas për të parë mundësinë për investime të tjera në brendësi të shkollës për të lehtësuar lëvizjen e këtyre personave.

## NGROHJA

Nga vëzhgimi i kryer në shkollën e mesme 'Shefqet Guzi' rezulton se shkolla ka një sistem ngrohje qendror, i cili është operativ në periudhën kohore nëntor-janar. Ky sistem ngrohje përdor si lëndë djegëse biomasën (lëndë drusore).

## GJETJE

- Për qëllimin e përmirësimit të higjienës së tualeteve në shkollë është e nevojshme një vëmendje më e lartë nga ana e drejtorisë së shkollës, nëpërmjet sanitarëve për një mirëmbajtje më të vazhdueshme.
- Për komponentin e infrastrukturës duhet një vlerësim më i thelluar dhe një diskutim i hapur ndërmjet qytetarëve, drejtorisë së shkollës dhe bashkisë për të parë mundësinë e investimit në rregullimin e këtyre komponentëve infrastrukturorë të tillë si (dyert, lavamani, lagështira etj)
- 3 dritare janë të pajisura me një xham dhe nuk janë plotësisht hermetike. Në këtë rast duhet parë mundësia për zëvendësimin e tyre duke zhvilluar një dialog të hapur me studentët për të prioritizuar investimet ndërmjet atyre për rikonstruksionin e tualeteve apo zëvendësimit të dritareve.
- Në gjimnazin 'Shefqet Guzi' nuk janë të pranishme rampat për personat me vështirësi në lëvizje si në pjesën e jashtme të sajën ashtu edhe në atë të brendshme. Për këtë arsye sugjerojmë ndërtimin e një rampe minimalisht në hyrjen e shkollës pasi ka një kosto të ulët e më pas për të parë mundësinë për investime të tjera në brendësi të shkollës për të lehtësuar lëvizjen e këtyre personave.


# BASHKIA BELSH

Bashkia e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me bashkinë Cërrik, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit. Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19.503 banorë, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 32.389 vetë dhe densitet prej 168.88 banorë për km$^2$. Sipërfaqja e bashkisë së re është 196.44 km2. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative: Belsh – qendra e Bashkisë, Grekan, Kajan, Fierzë, Rrasë.


Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra. Bashkia e Belshit shtrihet pothuajse tërësisht në pllajën kodrinore karstike të Dumresë, një zonë kodrash të buta me bazë gëlqerore mbi të cilat është krijuar një panoramë piktoreske me 85 liqene karstike me një sipërfaqe të përgjithshme prej 14.2 km$^2$. Kodrat e Dumresë qenë në përgjithësi të mbuluara me pyje dushku. Belshi është një bashki tërësisht rurale me produkte të diversifikuara nga blegtoria te zarzavatet dhe bostanoret, por një numër fermerësh janë përqendruar te kultivimi i duhanit, për të cilin janë specializuar.



# PËRMBLEDHJE E GJETJEVE NGA VËZHGIMI I KRYER NË TERREN NË BASHKINË BELSH



## SHËRBIMI I MBLEDHJES, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE





**Mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve**

Shumë mirë
Mirë









**Vendqëndrimi i kontejnerëve**

Shumë mirë
Mirë
Keq









**Pastërtia rreth kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq









**Shkalla e mbushjes së kontejnerit**

- Mirë
- Keq











## GJETJE

- Në pjesën më të madhe, komponentët e vëzhguar mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve, vendqëndrimi i kontejnerëve dhe pastërtia rreth kontejnerit janë vlerësuar me mirë dhe shumë mirë.


- Pjesa më e madhe e kontejnerëve është vlerësuar me keq. Një pjesë e madhe e kontejnerëve janë pa rrota dhe të djegur. Në këtë rast, kjo problematikë duhet të adresohet në organet përkatëse, në mënyrë që kontejnerët të lyhen dhe të ju vendosen rrota dhe kapakë, ose të zevendësohet me të rinj.

- Në 3 pikat e grumbullimit në zonën "Nga kryqëzimi te fabrika e miellit" dhe te "Çezma e vjetër", të cilat janë vlerësuar keq duhet të ndërhyhet për ndërtimin e 3 xhepave, në mënyrë të tillë, që kontejnerët të kenë vendin e tyre e të mos kthehen në burime të mundshme incidentesh.


- 12 kontejnerë në zonën "Nga kryqëzimi te fabrika e miellit", "Rr. Aziz Dervishi", "Rr. Mullinjz", "31 gushti" dhe "Çezma e vjetër", të cilët janë vlerësuar me keq nga qytetarët kanë nevojë për 10 kapakë, lyerje dhe 4 rrota në total. Ndërkohë, 4 kontejnerë në zonën nga "Kryqëzimi te fabrika e miellit" dhe te "Çezma e vjetër", të cilët janë vlerësuar shumë keq duhet të ndërrohen. , vëzhguesit kanë vlerësuar se 27 kontejnerët e vlerësuar nuk kanë kapak. Në këtë rast, kjo problematikë duhet të adresohet te organet përkatëse, në mënyrë që të vendosin kapakët në çdo kontejnerë.

- Nga vëzhgimi, vërehet se qytetarët dhe bizneset hedhin mbetje inerte në kontejner, pasi sipas tyre nuk kanë një vend grumbullimi për këto lloj mbetjesh. Gjithashtu, është shumë e nevojshme të punohet më shumë me ndërgjegjësimin e qytetarëvë dhe bizneseve në zonat e monitoruara.

# PARQE DHE LULISHTE





Vëzhguesit e trajnuar kanë monitoruar komponentët e përcaktuar të shërbimit të mirëmbajtjes së parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike me një frekuencë njëherë në javë, për dy javë në parkun pranë liqenit, të cilin për arsye studimore vëzhguesit e kanë ndarë në pesë segmentë për t'u vlerësuar nga vëzhguesit.





**Mirëmbajtja e pemëve, shkurreve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq




**Mirëmbajtja e barit**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq





**Zona e lojërave**

- Shumë mirë
- Mirë
- Shumë keq









**Zona e lojërave dhe aksesi për PAK**

- Po, ka
- Jo, nuk ka









**Pastërtia e parqeve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq









**Rrugët e kalimit në parqe**

Shumë mirë
Mirë









**Mirëmbajtja e stolave**

Shumë mirë
Keq








**Objekte sanitare në brendësi të parkut**

- Ka, në gjendje të mirë
- Ka, ne gjendje te keqe
- Nuk ka





## GJETJE

- Në lidhje me komponentin mirëmbajtja e pemëve dhe shkurreve, si shqetësim i parë nga vëzhguesit është nevoja për të mirëmbajtur më shumë pemët dhe shkurret. Në këtë rast punëtorët e bashkisë duhet t'i kushtojnë më shumë vëmëndje mirëmbajtjes së pemëve dhe shkurreve.

- Duke parë hapësirat e këtyre lulishte është e nevojshme, që të mendohet një investim afat shkurtër/ afat mesëm për zëvendësimin e lojërave të dëmtuara ose blerjen e lojërave të reja. Pjesa më e madhe e lojërave është në gjendje të mirë, por disa lojëra në segmentë të ndryshme kanë nevojë të zëvëndësohen, në mënyrë që mos të bëhën të rrezikshme për fëmijët.

- Në këtë bashki mungojnë hapësirat e dedikuara për personat me aftësi të kufizuar. Për këtë arsye është e nevojshme të merren masa si p.sh, vendosja e lojërave  të përshtatshme për të siguruar aksesin e tyre në zonat e monitoruara.


- 71 stolat e vlerësuar kanë nevojë për dërrasa të reja apo dhe lyerje në zonën "Parku pranë liqenit", "Sami Frashëri" dhe "SH58 Belsh".


- Objekti sanitar ka nevojë për vendosjen e 2 xhamave, te dera dhe dritarja dhe vendosjen e 1 brave.

# SHKOLLAT


Për qëllimin e këtij projekti është vëzhguar dhe vlerësuar shkolla e mesme e qytetit "Sami Frashëri", një nga shkollat më të rëndësishme në Bashkinë e Belshit, e cila është rikonstruktuar. Ky investim i kryer nga bashkia së fundmi duhet të mirëmbahet edhe nga nxënësit e shkollës.


**Gjendja e tualetit**




**Mirëmbajtja e higjienës**








## PRANIA E RAMPAVE





## NGROHJA

Nga vëzhgimi i kryer në shkollën e mesme 'Sami Frashëri" rezulton se shkolla ka një sistem ngrohje qendror, i cili funksionon me naftë. Gjatë periudhës së dimrit sistemi i ngrohjes qendrore nuk funksionon, sepse shkolla nuk ka mundësi të blejë naftën me çmimin e tregut. Nafta është një produkt që i nënshtrohet akcizës. Ne sugjerojmë që nafta të blihet pa akcizë. Gjatë periudhës së dimrit, nxënësit ngrohen me rezistencë.

## GJETJE


- Tre komponentët e vëzhguar higjiena në tualetet e shkollës, gjendja e tualeteve (infrastruktura) dhe mirëmbajtja e tualeteve janë vlerësuar 100% shumë mirë.
- Sistemi qendror i ngrohjes nuk funksionon gjatë periudhës së dimrit, sepse shkolla nuk ka mundësi ta blejë naftën, e cila është një produkt që i nënshtrohet akcizës.

# BASHKIA CËRRIK


Bashkia Cërrik ndodhet afërsisht dhjetë kilometra në jugperëndim të qytetit të Elbasanit. Bashkia Cërrik shtrihet midis lumenjve lumit Shkumbin dhe lumit Devoll. Qyteti ka një klimë të nxehtë mesdhetare. Sipërfaqja e Bashkisë Cërrik është 189.65 $km^2$. Shpërndarja e popullësisë në Bashkinë Cërrik është 27,445 banorë sipas Census 2011. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative: Cërrik – qendra e Bashkisë, Gostimë, Mollas, Shalës, Klos.



# PËRMBLEDHJE E GJETJEVE NGA VËZHGIMI I KRYER NË TERREN NË BASHKINË CËRRIK



## SHËRBIMI I MBLEDHJES, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE




**Mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq
- Shumë keq









**Vendqëndrimi i kontejnerëve**

- Mirë
- Keq








**Pastërtia rreth kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq
- Shumë keq









**Shkalla e mbushjes së kontejnerit**

- Mirë
- Keq









## GJETJE

- Lidhur me komponentin mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve duhet parë më nga afër problematikat e pikave te grumbullimit, të cilat janë vlerësuar keq dhe shumë keq dhe arsyet se përse ka mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve.


- 6 pika të grumbullimit në zonën "Ditura", "Rinia", "1 Maji", "14 Maji", "Rr, Cërrik- Elbasan" përsa i përket komponentit vendqëndrimi i kontejnerëve nuk kanë platforma. Kjo është një problematikë, e cila duhet adresuar dhe duhet te ndërtohen 6 platforma, në mënyrë që kontejnerët të mos bëhen burim incidenti.

- Në Bashkinë Cërrik, lidhur me komponentin e pastërtisë rreth kontejnerëve duhet parë më nga afër, se përsë pikat e grumbullimit në zonën "Rinia", " Rr. Cërrik- Elbasan", të vlerësuara me keq dhe shumë keq kanë mbetje voluminoze dhe në këtë rast mund të këtë vend për të punuar me qytetarët për të rritur ndërgjegjësimin për depozitimin e mbetjeve.

- Kontejnerë kanë nevojë të zëvëndësohet me kontejnerë me rrota, në mënyrë që të lehtësohet puna e punëtorëve të bashkisë për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve.

# PARQE DHE LULISHTE







**Mirëmbajtja e pemëve dhe lulishteve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq








**Mirëmbajtja e barit**

- Shumë mirë
- Mirë






**Zona e lojërave**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq







**Zona e lojëra dhe aksesi për PAK**

- Po, ka
- Jo, nuk ka









**Pastërtia e parkut**

- Shumë mirë
- Mirë







**Rrugët e kalimit në parqe**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq









**Mirëmbajtja e stolave**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq
- Shumë keq












Në parkun në periferi ka disa problematika të renditura mëposhtë:

- Parku nuk ka stola për qytetarët.
- Në park mungon sipërfaqja me bar dhe nuk ka kosha të vegjël.
- Parkun në periferi mund te kthehet ne burim aksidenti per femijet pasi është i pozicionuar ne buzë te rrugës, pra duhen vendosur masa mbrojtëse.

## GJETJE:

Sipas vëzhguesve, është e nevojshme marrja në konsideratë për vendosjen e lojërave për fëmijët me vështirësi në lëvizje, në mënyrë që dhe ata të kenë një mjedis ku të argëtohen.

- Në parkun në qendër, 7 stola kanë nevojë për lyerje dhe dërrasa te reja, që janë vlerësuar keq, ndërsa 5 stola duhet të ndërrohen sepse nuk jane funksional.

- Ndërtimi i 1 objekti sanitar nevojitet për qytetarët.

- Gjithashtu, është i nevojshën zëvëndësimi i koshave të vegjël me të rinj sepse janë të dëmtuar.








## SHKOLLA

Për qëllimin e këtij projekti është vëzhguar dhe vlerësuar shkolla e mesme e qytetit "Mehmet Bajraktari".

**Mirëmbajtja e higjienës**






**Gjendja e tualetit**










**Mirëmbajtja e dritareve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq



## PRANIA E RAMPAVE



## NGROHJA

Në shkollën "Mehmet Bajraktari" ka sistem të ngrohjes qendrore, i cili nuk funksionon sepse shkolla nuk ka mundësi ta blejë lëndën djegëse me çmimin e tregut. Nxënësit ngrohen me sobë zjarri gjatë periudhës nëntor-mars.

## GJETJE


- Në shkollën e mesme " Mehmet Bajraktari", 7 dritare duhet të ndërrohen sepse nuk janë funksionale.
- Gjithashtu, sipas vlerësimit të vëzhguesve duhet të marrë në konsideratë nevojën për vendosjen e një rampe për fëmijët me vështirësi në lëvizje.
- Në Bashkinë Cërrik duhet marrë në konsideratë blerja e naftës pa akcizë, në mënyrë që të funksionojë sistemi qendror i ngrohjes për nxënësit gjatë periudhës së dimrit.
- Gjithashtu, nxënësit kanë ngritur si problem mungesën e tualeteve. Për këtë arsye duhet marrë në konsideratë ndërtimi i më shumë tualeteve për nxënësit.
- Monitoruesit kanë ngritur si problem mungesën e hapësirës së palestrës. Për këtë arsye duhet marrë në konsideratë ndërtimin e palestrës për nxënësit.

# BASHKIA PEQIN


Bashkia e Peqinit shtrihet ne pjesen qendrore te Shqipërise i kufiziar nga qyteti i Rrogozhines dhe Elbasanit. Shpërndarja e popullësisë në Bashkinë Peqin është 26,136 persona sipas Census 2011. Sipërfaqja e Bashkisë së Peqinit është 197.79 $km^2$. Bashkia Peqin përbëhet nga 6 njësi administrative: Peqin – qendra e Bashkisë, Pajovë, Karinë, Përparim, Gjocaj, Shezë.



# PËRMBLEDHJE E GJETJEVE NGA VËZHGIMI I KRYER NË TERREN NË BASHKINË PEQIN



## SHËRBIMI I MBLEDHJES, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE





**Mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve**

Shumë mirë
Mirë











**Vendqëndrimi i kontejnerëve**

Mirë
Keq










**Pastërtia rreth kontejnerëve**

Shumë mirë
Mirë










**Shkalla e mbushjes së kontejnerit**

Mirë
Keq















## GJETJE


- Sipas vëzhguesve, 5 pikat e grumbullimit në Rr. Ismail Haki Kadiu" dhe "Mahmund Kaziu" kanë nevojë për platformë ose rrethim mbrojtës, në mënyrë që pikat e grumbullimit të mos bëhen burim incidenti.

- Gjithashtu, 1 kontejner në Rr."Ismail Haki Kadiu" duhet ndërruar sepse të gjithë elementët e tij janë të dëmtuar.

# PARQE DHE LULISHTE





Vëzhguesit e trajnuar kanë monitoruar komponentët e përcaktuar të shërbimit të mirëmbajtjes së parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike me një frekuencë një herë në javë, për dy javë, në parkun pranë bulevardit " Mustafa Gjinishi".





**Mirëmbajtja e pemëve dhe shkurreve**

- Shumë mirë
- Mirë









**Mirëmbajtja e barit**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq










**Rrugët e kalimit në parqe**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq









**Mirëmbajtja e stolave**

- Shumë mirë
- Mirë








**Objekte sanitare në brendësi të parkut**

- Ka, në gjendje të mirë
- Ka, ne gjendje te keqe
- Nuk ka

## GJETJE


- Vëzhguesit kanë vlerësuar nevojën për përmirësimin e mirëmbajtjes së pemëve dhe shkurreve, si dhe të barit.

- Në parkun e vëzhguar pranë bulevardit "Mustafa Gjinishi" nuk ka zonë lojërash për fëmijë. Në këtë rast, bashkia e Peqinit duhet të angazhohet për vendosjen e disa lojërave, në mënyrë që fëmijët të kenë një alternativë argëtimi. Gjithashtu, në fokus duhet të ketë dhe vendosjen e disa lojërave për fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Sipas vëzhguesve, duhet ndërtuar 1 objekt sanitar për qytetarët në parkun e vlerësuar nga vëzhguesit pranë bulevardit "Mustafa Gjinishi".


## SHKOLLA

Në bashkinë Peqin është vëzhguar dhe vlerësuar gjimnazi "Mustafa Kemal Ataturk". Kjo shkollë është rikonstruktuar së fundmi dhe ky investim duhet të mirëmbahet nga nxënësit e shkollës.





**Mirëmbajtja e higjienës**

Shumë mirë
Shumë keq





**Gjendja e tualetit**

Shumë mirë
Shumë keq








**Mirëmbajtja e dritareve**

Shumë mirë
Shumë keq



## PRANIA E RAMPAVE




## PRANIA E SISTEMIT TË NGROHJES QENDRORE

Nga vëzhgimi i kryer në shkollën e mesme " Mustafa Kemal Ataturk" rezulton se shkolla ka një sistem ngrohje qendror i cili është operativ në periudhën kohore nëntor-janar. Ky sistem ngrohje funksionon me energji elektrike.

## GJETJE

- Kjo shkollë është rikonstruktuar sëfundmi dhe ky investim duhet të mirëmbahet nga nxënësit e shkollës.
- Nga vëzhgimi i kryer, rezulton se shkolla ka një sistem ngrohje qendror, i cili është operativ në periudhën kohore nëntor-janar. Ky sistem ngrohje funksionon me energji elektrike.




# BASHKIA ELBASAN


Bashkia Elbasan është qendra e qarkut Elbasan, shtrihet në pjesën qendrore të vendit dhe kufizohet në veri me Bashkinë e Tiranë, në lindje me bashkitë Librazhd e Përrenjas, në jug me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkinë Cërrik dhe Belsh. Ajo ka në përberje të saj 13 njësi administrative: Elbasan – qendra e bashkisë, Laninot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Paper, me një popullësi prej 141,174 banorësh, sipas INSTAT, Census 2011.
Bashkia Elbasan shtrihet në një territor kryesisht kodrinor-fushor dhe pjesërisht kodrinor-malor, me klimë mesdhetare kontinentale me dimër të ftohtë, me reshje e me verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore arrin minimalen prej 12.2 °C e maksimalen prej 20.5 °C.



# PËRMBLEDHJE E GJETJEVE NGA VËZHGIMI I KRYER NË TERREN NË BASHKINË PEQIN



## SHËRBIMI I MBLEDHJES, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE





**Mbetje voluminoze brenda dhe përreth kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq











**Vendqëndrimi i kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq







**Pastërtia rreth kontejnerëve**

- Shumë mirë
- Mirë
- Keq











**Shkalla e mbushjes së kontejnerit**

- Mirë
- Keq
















## GJETJE

- 2 pikat e grumbullimit në zonën " Pallati i sportit" dhe "Rr. Labinoti" kanë nevojë për platformë ose rrethim mbrojtës.
- Lidhur me komponentin e pastërtisë rreth kontejnerëve duhet parë më nga afër, se përse pikat e grumbullimit në Rr. "Jonaq Kilica", në zonën "Pallati i Sportit", Rr. "Labinoti"të vlerësuara me keq dhe shumë keq kanë mbetje voluminoze dhe në këtë rast mund të këtë vend për të punuar me qytetarët për të rritur ndërgjegjësimin për depozitimin e mbetjeve.
- Sipas vëzhguesve, 12 kontejnerëve ju duhen 12 kapakë dhe lyerje, ndërsa 8 kontejnerë në rrugën "Jonaq Kilica" dhe në zonën "Pallati i Sportit" duhet të zëvëndësohen me kontejnerë të rinj janë vlerësuar shumë keq.

# PARQE DHE LULISHTE




Vëzhguesit e trajnuar kanë monitoruar komponentët e përcaktuar të shërbimit të mirëmbajtjes së parqeve , lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike me një frekuencë njëherë në javë, për dy javë në parkun e njohur nga banorët si parku pranë pallatit të sportit.





**Mirëmbajtja e pemëve dhe shkurreve**

Shumë mirë









**Mirëmbajtja e barit**

Mirë









**Rrugët e kalimit në parqe**

Shumë mirë









**Mirëmbajtja e stolave**

Shumë mirë

Mirë









**Zona e lojërave**

Shumë mirë





**Zona e lojërave dhe aksesi për PAK**

Po, ka

Jo, nuk ka









**Pastërtia e parkut**

Shumë mirë
Mirë








**Objekte sanitare në brendësi të parkut**

Ka, në gjendje të mirë
Ka, në gjendje të keqe
Nuk ka


## GJETJE

- Në parkun e vlerësuar mungojnë objektet sanitare. Për këtë aryse, është e nevojshme marrja në konsideratë e ndertimit të 1 objekti sanitar për qytetarët.
- Në parkun pranë "Pallatit të Sportit", nga vlerësimi i vëzhguesve duhet të riparohen 2 stola dhe të ju vendosen dy dërrasa.
- Gjithashtu, është e nevojshme marrja në konsideratë e vendosjes së 2-3 lojërave më shumë për fëmijët dhe në veçanti vendosja e 2-3 lojërave për fëmijët me aftësi të kufizuar.
- Në lidhje me komponentin pastërtia e parkut, duhet t'i kushtohet më shumë vëmëndje pastërtisë së parkut dhe të ndërgjegjësohen qytetarët, që mos të hedhin mbeturinat në vende të përshtatshme.

## SHKOLLA


Në bashkinë e Elbasanit është vëzhguar nga qytetarët gjimnazi "Dhaskal Todri". Gjimnazi "Dhaskal Todri" i qytetit të Elbasanit prej vitesh renditet ndër më të mirët e vendit tonë. Ky gjimnaz në Analizën kombëtare të Maturës 2018, sipas raportit të publikuar nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si dhe Q.SH.A është renditur i pesti në shkallë kombëtare dhe më i miri në të gjithë Qarkun e Elbasanit duke shënuar kështu një tjetër sukses të jashtëzakonshëm që nga koha e krijimit të tij 53 vite më parë.

**Mirëmbajtja e higjienës**








**Gjendja e tualetit**





## PRANIA E RAMPAVE

Në shkollën e vëzhguar nuk ka rampa për fëmijët me vështirësi në lëvizje. Për këtë arsye, duhet t'i kushtohet një vëmëndje e veçantë vendosjes së rampave në shkollë për fëmijët me vështirësi në lëvizje, në mënyrë që ata të kenë me të lehtë aksesin në shkollë.

## PRANIA E SISTEMIT TË NGROHJES QENDRORE

Në shkollën "Dhaskal Todri" nuk ka sistem të ngrohjes qendrore. Nga ky vëzhgim duhet të merret në konsideratë vendosja e sistemit të ngrohjes qendrore, në mënyrë të tillë që nxënësit të ndjekin orët mësimore në kushte të mira..

## GJETJE

- Vëzhguesit kanë vlerësuar nevojën për rikonstruksionin e tualeteve sepse higjiena dhe infrastruktura e tualetit janë në gjendje shumë të keqe.
- Vëzhguesit kanë konstatuar se 11 dritare duhet të ndërrohen, sepse nuk janë hermetike dhe nuk kanë xham të dyfishtë.
- Gjithashtu, në gjimnaz mungon sistemi i ngrohjes qendrore. Nga ky vëzhgim duhet të merret në konsideratë nga Bashkia e Elbasanit vendosjen e sistemit të ngrohjes qendrore. Kjo sjelll përmirësimin e kushteve gjatë orës mësimorë për nxënësit e shkollës.

## QYTETARËT E PËRFSHIRË NË PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE: PRAKTIKA TË MIRA

Rezultatet të vëzhguesve të trajnuar të bashkive të Qarkut Elbasan përshkruajnë cilësinë aktuale të tre shërbimeve publike.

Në lidhje me shërbimin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, mesatarisht:
• kontejnerët e shërbimit gjenden të dëmtuar, pa kapakë dhe pa rrotaq, gjë që vështirëson punën e punëtorëve të bashkisë për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;
•kontejnerët nuk kanë vendqëndrim të posaçëm ose nuk janë të rrethuar;
• shkalla e mbushjes së kontejnerëve nuk është e lartë;
• mjedisi përreth kontejnerëve është i pastër.

Në lidhje me shërbimin e mirëmbajtjes së parqeve, lulishteve, hapësirave të gjelbra publike, mesatarisht:
• objektet sanitare mungojnë;
• këndi i lojërave për fëmijët me aftësi të kufizuar mungon;
• stolat janë gjetur të dëmtuar, me nevojën për mirëmbajtje më të shpeshtë në mënyrë që të ulen kostot e riparimit apo blerjes së stolave të rinj.

Në lidhje me ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor para universitar, mesatarisht:
• Sistemi i ngrohjes qendrore nuk funksionon;
• Dritaret e shkollës duhet të zëvëndësohen.

Në fazën finale të zbatimit të TVT u zhvilluan  dëgjesa publike në bashkitë e Qarkut Elbasan pjesë të projektit me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse për shërbimet publike pranë bashkive, përfaqësues të këshillave bashkiakë, si dhe qytetatarë, me qëllim prezantimin e metodologjisë, vëzhguesve dhe të rezultateve të projektit.

Rezultatet e projektit dhe rekomandime për ndërhyrje iu parashtruan drejtorive përgjegjëse për shërbimet publike dhe për buxhetin pranë bashkive, në formën e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, duke mbyllur kështu ciklin e plotë të monitorimit dhe vlerësimit të tre shërbimeve të përzgjedhura. Përkrah zbatimit në vetvete të teknikës së Vëzhguesve të Trajnuar nga qytetarët, zhvillimi i dëgjesa publike gjithashtu është një sukses kryesor i projektit.

5 TRAJNIME

80 PERSONA TË TRAJNUAR

48 PIKA GRUMBULLIMI MBETJESH TË VËZHGUARA

5 SHKOLLA TË VËZHGUARA

8 HAPËSIRA TË GJELBRA TË VËZHGUARA

100 PERSONA PJESËMARRËS

6 ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK PJESËMARRËS

15 PËRFAQËSUES TË BASHKISË PJESËMARRËS

5 FISHA BUXHETORE

5 DËGJESA PUBLIKE

## Forma e kërkesave buxhetore të përgatitura nga vëzhguesit për PBA 2022-2025

Fishat e buxhetit për shërbimet e monitoruara në bashkitë e qarkut Elbasan janë prezantuar nga vëzhguesit e trajnuar pranë komisioneve të buxhetit të secilit Këshill Bashkiak përgjatë periudhës tetor-nëntor 2021.

Një pjesë e problematikave të ngritura në këto fisha janë adresuar nga bashkitë përgjatë periudhës së zbatimit të projektit, me fonde nga buxhetet e vitit 2021, përkatësisht ato të lidhura me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu, një pjesë tjetër e problematikave të ngritura përputhen me objektivat e ardhshme të programeve buxhetore afatmesëm 2022-2025 të secilës bashki.

**PROJEKTI: PËRMIRËSIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË MBLEDHJES, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE NË RRUGËN "ISMAIL HAKI KADIU" DHE "MAHMUD KAZIU" BASHKIA PEQIN**

**FUNKSIONI: MBLEDHJA, LARGIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE.**

### PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT

#### SITUATA AKTUALE

Në bashkinë Peqin, nëpërmjet 7 pikave të vëzhguara dhe vlerësuara nga Rrjeti i Vëzhguesve të Trajnuar, Bashkia Peqin, URI & KEE, për shërbimin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta mund përshkruhet kjo situatë aktuale:

1. Pikat e grumbullimi të mbetjeve kanë nevojë për platforma ose rrethim mbrojtës, të cilat janë të nevojshëm për shmangien e aksidenteve dhe për krijimin e një mjedisi më të pastër e të këndshëm të trotuareve dhe rrugëve për kalimtarët.

2. Kontejnerët kanë nevojë të zëvendësohen ose të riparohen pjesë të tij.

#### SYNIMI I PROJEKTIT

Viti 2022

1. Përmirësimi i gjendjes fizike të pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe të kontejnerëve.

#### AKTIVITETET KRYESORE TE PROJEKTIT

Viti 2022

1. Ndërtimi i 5 platformave të pikave të grumbullimit të mbetjeve,
2. Zëvendësimi i 1 kontejneri të ri të dëmtuar.

**PROJEKTI: PËRMIRËSIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË MBLEDHJES, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE NË RRUGËN "ISMAIL HAKI KADIU" DHE "MAHMUD KAZIU" BASHKIA PEQIN**

**FUNKSIONI: MBLEDHJA, LARGIMI DHE TRAJTIMI I MBETJEVE TË NGURTA DHE SHTËPIAKE.**

## REZULTATET QË PRISNI

Viti 2022

1. Përmirësimi i pastërtisë së mjedisit përreth kontejnerëve,
2. Rritja e sigurisë dhe kënaqshmërisë së kalimtarëve pranë pikave të grumbullimit të mbetjeve.

| **AKTORËT E MUNDSHËM** (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen) | **KONTRIBUTET E MUNDSHME NË PROJEKT** (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.) |
|---|---|
| Bashkia Peqin<br>Qytetarët | Bashkia Peqin |

**SHPENZIMET E LLOGARITURA** (për çdo aktivitet të mësipërm)

| SHPENZIMET PËR ÇDO AKTIVITET | | TOTALI (lek) | NGA KJO: Paga, sig | Operative | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Krijimi i xhepave/platformave për vendosjen e kontejnerëve (për 5 copë) | 55,055 | | 55,055 | |
| A.2 | Kontejnerë të rinj (për 1) | 30,000 | | | 30,000 |
| TOTALI | | 85,055 | | 55,055 | 30,000 |

| **PERIUDHA E ZBATIMIT** (kur fillon, kur përfundon) | **PËRGATITI DHE NDJEK REALIZIMIN E PROJEKTIT:** |
|---|---|
| Gjatë vitit 2022 | Rrjeti i vëzhguesve të trajnuar, Bashkia Peqin, URI & KEE |

**PROJEKTI: "PËRMIRËSIMI I MIRËMBAJTJES SË PARQEVE DHE LULISHTEVE NË BASHKINË CËRRIK"**

**FUNKSIONI: PARQET, LULISHTET DHE HAPËSIRAT E GJELBRA PUBLIKE – ME FOKUS INFRASTUKTURËN PAK**

## PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT

### SITUATA AKTUALE

Në bashkinë Cërrik, nëpërmjet parkut "në qendër" dhe "në Periferi" të vëzhguar dhe vlerësuar nga Rrjeti i Vëzhguesve të Trajnuar, Bashkia Cërrik, URI & KEE, për shërbimin e parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike mund përshkruhet kjo situatë aktuale:

**1.Mirëmbajtja e parqeve dhe lulishteve**
Mirëmbajtja e pemëve dhe shkurreve dhe barit në parkun 'në qendër' është në gjendje shumë të mirë, parqet janë të krasitura mirë dhe me kriter, nuk ka pemë të thara apo degë të thyera e të varura në asnjë rast.
Mirëmbajtja e parkut 'në periferi' është e dobët, mungon sipërfaqja e barit, stolat, dhe koshat e vegjël të mbetjeve.

**2. Siguria e parqeve:**
Parkun 'në periferi', duke qenë i vendosur në buzë të rrugës së automjeteve mbart risk për aksidentim të fëmijëve dhe banorëve në të; nevojitet të vendosen masa mbrojtëse.

**3. Kushtet higjieno-sanitare:**
Objektet sanitare mungojnë në përgjithësi në parqe.

### SYNIMET E PROJEKTIT

Viti 2022

1. Përmirësimi i gjendjes aktuale të 5 stolave të parkut "në periferi".
2. Ndërtimi i 1 objekti sanitar në parkun "në qendër".

### AKTIVITETET KRYESORE TE PROJEKTIT

Viti 2022

1.Vendosja e 5 stolave të reja në parqe,
2.Ndërtimi i strukturave sanitare në parkun "në qendër".

**PROJEKTI: "PËRMIRËSIMI I MIRËMBAJTJES SË PARQEVE DHE LULISHTEVE NË BASHKINË CËRRIK"**

**FUNKSIONI: PARQET, LULISHTET DHE HAPËSIRAT E GJELBRA PUBLIKE – ME FOKUS INFRASTUKTURËN PAK**

## REZULTATET QË PRISNI

Viti 2022

1. Përmirësimi i infrastrukturës së parqeve
2. Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në parqe.

| **AKTORËT E MUNDSHËM** (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen) | **KONTRIBUTET E MUNDSHME NË PROJEKT** (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.) |
|---|---|
| Bashkia Cërrik (Organet Përkatëse), Drejtoria e Shërbimeve Publike. | Bashkia Cërrik (Organet Përkatëse), Drejtoria e Shërbimeve Publike. |

## SHPENZIMET E LLOGARITURA (për çdo aktivitet të mësipërm)

| | SHPENZIMET PËR ÇDO AKTIVITET | TOTALI (lek) | NGA KJO: Paga, sig | Operative | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | 5 stola të rinj | 44,950 | | | 44,950 |
| A.2 | Ndërtimi i 1 objekti sanitar | 30,000 | | | 30,000 |
| **TOTALI** | | **74,950** | | | **74,950** |

| **PERIUDHA E ZBATIMIT** (kur fillon, kur përfundon) | **PËRGATITI DHE NDJEK REALIZIMIN E PROJEKTIT:** |
|---|---|
| Gjatë vitit 2022 | Rrjeti i vëzhguesve të trajnuar, Bashkia Cërrik, URI & KEE |

**PROJEKTI: VLERËSIMI I NDËRTIMIT, REHABILITIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË NDËRTESAVE ARSIMORE TË SISTEMIT SHKOLLOR PARAUNIVERSITAR**

**FUNKSIONI: MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE SHKOLLORE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

## PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT

### SITUATA AKTUALE

Nëpërmjet vëzhgimit dhe vlerësimit të shkollës "Sami Frashëri" nga Rrjeti i Vëzhguesve të Trajnuar, Bashkia Belsh, URI & KEE, një nga shkollat më të rëndësishme në Bashkinë e Belshit, e cila është rikonstruktuar, për shërbimin e mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore të sistemit arsimor parauniversitar mund përshkruhet kjo situatë aktuale:

Ky investim i kryer nga bashkia së fundmi duhet të mirëmbahet edhe nga nxënësit e shkollës. Infrastruktura e ndërtimit dhe higjieno-sanitare është e mirë, por sistemi ekzistues dhe i ri qendror i ngrohjes nuk funksionon gjatë periudhës së dimrit, sepse nuk ka furnizim të vazhdueshëm e të rregullt me lëndën djegëse; lënda djegëse është e papërballueshme për buxhetin bashkiak për shkak të akcizës mbi të dhe të taksës së qarkullimit; nxënësit ngrohen me rezistencë gjatë periudhës së dimrit.

### SYNIMET E PROJEKTIT

Viti 2022

Plotësimi i dokumenteve ligjore të nevojshme të Bashkisë për të mbrojtur pranë institucioneve qendrore mundësinë e furnizimit të shkollës me naftë të blerë pa taksë qarkullimi.

### AKTIVITETET KRYESORE TE PROJEKTIT

Viti 2022

Punë administrative ligjore për të mundësuar plotësimin e dokumenteve dhe mbrojtjen e rastit.

**PROJEKTI: VLERËSIMI I NDËRTIMIT, REHABILITIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË NDËRTESAVE ARSIMORE TË SISTEMIT SHKOLLOR PARAUNIVERSITAR**

**FUNKSIONI: MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE SHKOLLORE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

## REZULTATET QË PRISNI

Viti 2022

1. Paraqitja pranë oragneve kompetente të dokumenteve.

| **AKTORËT E MUNDSHËM** (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen) | **KONTRIBUTET E MUNDSHME NË PROJEKT** (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.) |
|---|---|
| Bashkia Belsh (Organet Përkatëse) | Bashkia Belsh |

**SHPENZIMET E LLOGARITURA** (për çdo aktivitet të mësipërm)

| | | NGA KJO: | | |
|---|---|---|---|---|
| **SHPENZIMET PËR ÇDO AKTIVITET** | **TOTALI** (lek) | **Paga, sig** | **Operative** | **Kapitale** |
| | | | | |
| **TOTALI** | **0 ALL** | | | **0 ALL** |

| **PERIUDHA E ZBATIMIT** (kur fillon, kur përfundon) | **PËRGATITI DHE NDJEK REALIZIMIN E PROJEKTIT:** |
|---|---|
| Gjatë vitit 2022 | Rrjeti i vëzhguesve të trajnuar, Bashkia Belsh, URI & KEE |










Financuar nga LevizAlbania




Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC